

Inspektori i Lartë i Drejtësisë

BULETINI MUJOR

Nr.7

Korrik 2021



PROCEDIMI DISIPLINOR NË FOKUSIN E ILD, KLGJ E KLP

Hetimet dhe procedimet disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve ishin në fokus të takimit të përbashkët, të realizuar në datën 7 Korrik të iniciuar nga aktorët e përfshirë në këtë proces, Këshilli i Lartë Gjyqësor, Këshilli i Lartë i Prokurorisë dhe Inspektori i Lartë i Drejtësisë.

Prej themelimit më 1 Shkurt 2020, ILD filloi hetimet e para disiplinore ndaj magjistratëve, e në vijim KLGJ dhe KLP miratuan rregulloret e tyre përkatëse mbi procedurat disiplinore.

Zhvillimi i procedimeve të para disiplinore të paraqitura nga ILD në të

dy Këshillat, bazuar në legjislacionin e ri të reformës në drejtësi, ka nxitur krerët e institucioneve të reja, Inspektorin e Lartë të Drejtësisë Artur Metani, kryetaren e KLGJ Naureda Llagami, dhe Kryetarin e KLP Gent Ibrahimini të aktivizojnë këtë platformë komunikimi e koordinimi për të identifikuar problematikat me interes të përbashkët, që hasen gjatë zbatimit të ligjit, dakordësimin dhe koordinimin mbi zbatimin e standardeve uniforme, përmes garantimit të një procesi të rregullt disiplinor e në respekt të pavarësisë së magjistratëve.

Në këtë takim pune përcollën kontributet e tyre drejtuesit e misioneve ndërkombëtare që asistojnë insitucionet e drejtësisë, misioni i Bashkimit Europian, EURALIUS dhe misioni i Departamentit të Drejtësisë së SHBA, OPDAT.



ILD


INSPEKTORI I LARTË
I DREJTËSISË

Procedimi disiplinor

Aktivizimi i kësaj platforme komunikimi e koordinimi mes Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë synon dakordësimin dhe koordinimin mbi zbatimin e standardeve uniforme, përmes garantimit të një procesi të rregullt disiplinor e në respekt të pavarësisë së magjistratëve.



ANKESAT NË ILD



Ankimimi në ILD

Ankesa juaj mund të paraqitet në mënyrë elektronike me e-mail, nëpërmjet postës ose drejtpërdrejtë në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë (ILD).

Gjatë plotësimit të formularit të ankesës, kur paraqiteni personalisht pranë Zyrës së ILD, ju mund të asistoheni nga punonjësit e Sektorit të Ankesave. Orari i dorëzimit të ankesave pranë ILD bëhet cdo ditë të javës, nga e hëna deri të premten, nga ora **09:00-14:00**.

“Angazhimi kryesor i institucionit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë është ushtrimi i funksioneve gjyqësore në Republikën e Shqipërisë në mënyrë sa më të pavarur, të paanshme dhe me integritet nëpërmjet një sistemi përgjegjshmërie dhe llogaridhënie.”

SEKTORI I ANKESAVE

Sektori i ankesave në ILD është përgjegjës për garantimin e të drejtës së informimit të qytetarëve dhe transparencën ndaj publikut. Ky sektor ndjek gjurmueshmërinë e ankesave në sistem dhe jep përgjigje për ankuesit, mbi fazën ku ndodhet ankesa e tyre.

Në kuadër të transparencës, për një komunikim të shtuar me qytetarët e interesuar, krahas faqes dhe adresës zyrtare, Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka vënë në dispozicion numrin e telefonit +355 4 2217217.

STATISTIKA

Gjatë muajit **Korrik**, Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka administruar **122 ankesa** të cilat janë paraqitur nga qytetarë dhe institucione.

Konkretisht:

101 ankesa janë depozituar nga qytetarët;

21 ankesa kanë ardhur nga institucionet.

41 telefonata me qytetarë, të cilët kanë kërkuar informacion mbi fazën e ankesave të tyre. **25 takime** me qytetarët.

Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka kryer konfirmimin standard të marrjes së ankesës për të gjitha ankesat, që kanë hyrë për herë të parë në institucion, gjatë muajit Korrik 2021.

Ankesat që kanë subjekt të tyre prokurorë dhe gjyqtarë janë shpërndarë tek Inspektorët dhe ndodhen në faza të ndryshme, si shqyrtim fillestar, arkivim, verifikim, me projektvendimet përkatëse.



EURALIUS V VLERËSON INSPEKTORIN E LARTË TË DREJTËSISË

Bashkëpunimi i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me misionin EURALIUS V u evidentua përmes një ceremonie të përbashkët vlerësimi për anëtarë të stafeve respektive. Inspektori i Lartë i Drejtësisë Artur Metani vlerësoi ndihmesën e vyer të misionit EURALIUS ndër vite në vendin tonë për konsolidimin e sistemit të drejtësisë. “Eshtë një nga misionet e Bashkimit Evropian më produktive dhe më mbështetëse të zhvillimeve institucionale në Shqipëri.” u shpreh Inspektori i Lartë i Drejtësisë në takimin e datës 15 Korrik. Z. Metani nënvizoi kontributin e drejtuesve të EURALIUS ndër vite në Shqipëri. “Dua të kujtoj drejtuesit e parë gjyqtarin Coledan dhe Roland Miklau, me të cilët kam patur



bashkëpunim gjatë eksperiencës sime profesionale, të cilët vendosën themele të forta të një institucioni me integritet të lartë, e deri tek drejtuesja e sotme, znj. Bernhard”.

Nga ana e saj Dr. Agnes Bernhard vlerësoi lart Inspektorin e Lartë të Drejtësisë Artur Metani për bashkëpunimin me EURALIUS, e reflektuar edhe përmes ceremonisë së vlerësimit. “Duhet të kemi momente të tilla, kur gjatë punës që bëjmë, edhe vlerësojmë, edhe vlerësohemi. ILD është më i riu nga institucionet e qeverisjes së drejtësisë, por është një institucion që ka rezultate të shkëlqyera dhe që duhet të jetë shembull për institucionet e tjera. Ju faleminderit shumë për përkushtimin tuaj, leadershipin tuaj dhe angazhimin tuaj në krye të **(vijon në fq.4)**

Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.”

Në emër të EURALIUS V, drejtuesja e misionit Dr. Agnes Bernhard dorëzoi certifikata vlerësimi për disa punonjës të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, për kontributin e tyre në projekte të përbashkëta në funksion të ILD-së, konkretisht Inspektore Magjistrate Marsela Pepi, këshilltarëve ligjorë Periand Teta,

Elona Kana e Isida Koka, si dhe drejtores së drejtorisë së analizës ligjore dhe hartimit të akteve Eljona Bylykbashi. Ndërsa Inspektori i Lartë i Drejtësisë Artur Metani i dorëzoi një letër mirënjohjeje ekspertes ligjore të EURALIUS V, znj. Anita Mihailova, për angazhimin, kontributin dhe mbështetjen në ngritjen dhe forcimin e kapaciteteve të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.



5 VITE PAS MIRATIMIT TË REFORMËS NË DREJTËSI, SFIDA E INSTITUCIONEVE TË REJA MBETET MBËSHTETJA DHE BASHKËPUNIMI I KOORDINUAR MES PUSHTETEVE



Inspektori i Lartë i Drejtësisë mori pjesë në takim të zhvilluar në datën 23 Korrik “Reforma në drejtësi - 5 vjet më pas: finalizimi i strategjisë ndërsektoriale të drejtësisë 2021-2025”

Më poshtë, fjala e plotë të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë të mbajtur në këtë takim.

**E nderuar znj. Gjonaj,
I nderuar ambasador Soreca,
E nderuar ambasadore Kim,
Të nderuar kolegë të institucioneve të drejtësisë,
Të nderuar të ftuar,**

Zhvillimi i një strategjie të re vjen në një kohë kur të gjitha institucionet e sistemit të drejtësisë, janë krijuar, falë strukturës kushtetuese e ligjore të ndërtuar për një sistem e qasje të re ndaj sistemit të drejtësisë. Jemi

në momentin kur ka përfunduar cikli i ngritjes së institucioneve të reja të drejtësisë, si dhe pajisja e tyre me kapacitetet e nevojshme infrastrukurore dhe njerëzore për jetësimin e prioriteteve strategjike për vendin.

Pesë vjeçari që lamë pas, shërbeu për të kuptuar rëndësinë e nevojës për të transformuar një prej shtyllave sa delikate aq edhe të domosdoshme në një shtet të së drejtës. Inspektori i Lartë i Drejtësisë, në rrugëtimin e tij 17 muor, ka patur sfida të gjithanshme në ngritjen dhe fillimin e funksionimit të tij, që nga sigurimi i ambienteve të punës, tek plotësimi me burime njerëzore, sfida të cilat janë ende në proces.

Por, në këtë përshëndetje, do fokusohesha te planifikimi strategjik, si sistemi kryesor që garanton bashkërendimin dhe zbatimin e politikave të institucioneve kushtetuese, në terma afatgjatë për të siguruar

Gjatë fjalës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë

5 vite pas miratimit të reformës në drejtësi, sfida e vërtetë e institucioneve të reja mbetet mbështetja dhe bashkëpunimi i koordinuar mes pushteteve, në vlerësimin e kujdesshëm e të paanshëm të nevojave dhe adresimit në kohë të shqetësimeve dhe problematikave që evidentoohen, përmes mekanizmeve funksionale të monitorimit të zbatimit dhe atyre miratuese.

[Kliko](#) për të lexuar fjalën e Z. Metani në faqen zyrtare [ild.al](#).



shpërndarje efektive dhe të qëndrueshme të burimeve financiare.

Dua të përshëndes përpjekjen e muajve të fundit për të ofruar një planifikim të integruar të politikave sektoriale dhe hartimin e tyre në një dokument të integruar sipas aktorëve të sistemit të drejtësisë, të përkthyer këto në qëllime konkrete, me masa dhe indikatorë të matshëm, në fokus të të cilave mbetet vazhdimësia e reformave të ndërmarra.

Në këtë kuptim, me ngritjen e institucioneve të pavarura, procesi i planifikimit strategjik ka patur një përmirësim në sajë të gjithëpërfshirjes dhe rakhordimit të politikave në nivel planifikimi institucional të koordinuar dhe ndërthurur me planifikimin strategjik. Struktura e dokumentit strategjik, të vënë në dispozicion për mendim, mbështet zhvillimin e misionit institucional, në drejtim të vlerësimit dhe analizimit të kuadrit normativ mbi të cilin mbështetet veprimtaria, fuqizimit të kapaciteteve njerëzore dhe zhvillimit të mjeteve të teknologjisë në funksion të efijencës së dhënies së shërbimit.



Si në çdo fazë të hartimit të reformës, mbështetja e partnerëve ka qenë evidente dhe reflektohet edhe në cilësinë e përmbajtjes së këtij dokumenti. Megjithatë, çelësi i suksesit pritet të jetë përfshirja proaktive e institucioneve të pavarura në këtë proces, përfshirja e tyre duke marrë në konsideratë kërkesat dhe propozimet, pasi matja e rezultateve e objektivave do të jetë produkt i performancës së organeve të pavarura në përmbushjen e qëllimit madhor, atij të konsolidimit të sistemit të drejtësisë. Tashmë me dokumentin e ri për 5 vitet e ardhshme, del në pah nevoja për një qasje më gjithëpërfshirëse edhe në zhvillimin e politikave të sektorit buxhetor dhe shmangien e ndikimit të ekzekutivit në kontrollin e buxhetit të institucioneve të pavarura kushtetuese, si mjet për të garantuar autonominë dhe pavarësinë e institucionit.

Nga përvoja e deritanishme, një nga faktorët që ndikon në performancën e institucionit është edhe mënyra e dhënies së fondeve, përdorimi me efektivitet i tyre dhe përshtatshmëria e burimeve financiare, materiale e njerëzore në dispozicion të institucionit. Sigurimi i këtyre burimeve të mjaftueshme në kohë, garanton sigurimin e pavarësisë së institucioneve. Financimi sipas nevojës dhe përdorimi në mënyrë transparente, janë thelbësorë për të arritur objektivat e vendosur, në kohë dhe me cilësi.

5 vite pas miratimit të reformës në drejtësi, sfida e vërtetë e institucioneve të reja mbetet mbështetja dhe bashkëpunimi i koordinuar mes pushteteve, në vlerësimin e kujdesshëm e të paanshëm të nevojave dhe adresimit në kohë të shqetësimeve dhe problematikave që evidentohen, përmes mekanizmave funksionale të monitorimit të zbatimit dhe atyre miratuese.

Kemi lënë pas erën e ngritjes së institucioneve tona, e tani është koha e rezultateve, të matshme e cilësore, për të justifikuar tashmë besimin e publikut tek drejtësia.


Kjo është sfida e të ardhmes!
Ju faleminderit!

[Kikoni](#) për të ndjekur videon e plotë të fjalës së Z. Metani.

Korrik 2021

Të gjitha të drejtat e rezervuara Inspektori i Lartë i Drejtësisë

© ILD



KONTAKT ILD

WEB: ild.al

EMAIL: info@ild.al

ADRESA: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Godina nr.13
Tiranë, Shqipëri



[Inspektori i Lartë i Drejtësisë Artur Metani @ILD_Albania](https://twitter.com/ILD_Albania)



[Inspektori i Lartë i Drejtësisë](https://www.youtube.com/channel/UC...)



Spot prezantues ILD
Prezantimi i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë
[youtube.com](https://www.youtube.com/channel/UC...)

[Kliko për të ndjekur spotin prezantues të ILD](#)